



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:227674
Datë: 08.10.2024
Numri i dokumentit: 06268032

C.nr. 873/2017

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Argzon Muçaj, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses BKS me seli në Prishtinë, Rr. "L.P.", Magjistralja Prishtinë-Fushë Kosovë, p.nr, e përfaqësuar sipas autorizimit nga D.H., kundër të paditurit F.(R).A nga Prishtina, Rr. "V.F. ", nr.124, me objekt të padisë rimbursim i dëmit, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor me date 27.09.2024 në prezencën e përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, ndërsa e përpiloi me datë 08.10.2024, këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpapia e paditëses BKS me seli në Prishtinë.

II. DETYROHET i padituri F.(R).A nga Prishtina, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e datës 10.07.2013, t'ia kompensojë shumën prej 746.00 € (shtatëqind e katër dhjetë e gjashtë euro) me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila llogaritet nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në përmbushjen e tërësishme, e të gjitha në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit ligjor.

III. OBLIGOHET i padituri F.(R).A nga Prishtina, që paditëses në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia kompensojë shumën në lartësi prej 170.00 €, në afat prej 15 ditëve, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja BKS me seli në Prishtinë, ka parashtruar padi në këtë gjykatë me datë 05.04.2017, kundër të paditurit F.(R).A nga Prishtina, me objekt kontesti rimbursim i dëmit material dhe jo material.

Paditësja përmes padisë, përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me datën 10.07.2013, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit i cili sipas raportit policor ka ardhur për shkak të vozitësit të automjetit "A" – VW të tipit Sharan, me targa 01-724-CS, nga pakujdesia duke lëvizur mbrapa, me rrotën e parë të anës së majtë e ka goditur në këmbën e djathtë këmbësorin R.K. (tutje: i dëmtuari), i cili në momentin e aksidentit ishte duke ecur në trotuar. Ka shtuar se, si pasojë e aksidentit i dëmtuari përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur

kërkesë për kompensim të dëmit material dhe jo material. I njëjti është kompensuar nga paditësja në bazë të marrëveshjes jashtëgjyqësore. Tutje ka theksuar se, drejtuesi i automjetit, këtu i padituri, ka drejtuar automjetin pa mbulesë siguruese dhe për këtë paditësja mjetet e paguara nga kjo bazë ka të drejtë t'i regresojë drejtpërdrejt nga shkaktari i aksidentit. Nga gjykata ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditëses, ashtu që gjykata t'a detyrojë të paditurin F.(R).A nga Prishtina, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jo material, t'ia kompensojë shumën prej 746.00 € (shtatëqind e katër dhjetë e gjashtë euro) me kamatë ligjore prej 8% në vit e cila llogaritet nga paraqitja e padisë me datë 05.04.2017 e deri në përmbushjen e tërësishme, të gjitha në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbaramit ligjor.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20.00 € dhe në emër të ekspertizës së komunikacionit shumën prej 150.00 €, e gjithsejtë në shumën e përgjithshme prej 170.00 €.

I padituri përmes përgjigjes në padi, në seancat e mbajtura gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, duke shtuar se gjendja faktike është e ndryshme nga ajo që është paraqitur në raportin policor dhe nga paditësja. Pasi që i padituri ka qenë vetëm duke qëndruar në automobil, i cili (ka qenë i fikur) nuk ka qenë as i ndezur e as në lëvizje në momentin e aksidentit dhe se i dëmtuari së bashku me një grumbull fëmijësh i janë afruar automobilit duke e lëvizur dhe rrjedhimisht, ka arritur deri tek aksidenti. Nga gjykata ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pa bazuar, sepse provat që gjenden në shkresat e lëndës janë të pavërteta dhe të pasakta andaj, përmes tyre nuk mund të provohet drejtë gjendja faktike.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: Raporti i lëshuar nga Policia e Kosovës me nr. 2013-AR-1948 i dt.10.07.2013, Raporti i QKUK – Qendra Emergjente i dt. 10.07.2013, Vlerësimi mjekësor i datës 10.07.2013, Raportet mjekësore të datës 15.07.2013, 17.07.2013, 23.07.2013, 24.07.2013 të lëshuara nga QKMF, Konfirmimi i sigurimit i lëshuar me datë 25.07.2011 dhe me datë 24.07.2012, Formulari për kompensimin e dëmit jo material i datës 02.09.2013, Vendimi i komisionit të shkallës së parë për trajtimin e dëmeve i datës 02.09.2013, Vendimi i lëshuar nga paditësja i datës 02.09.2013, Kërkesa për dëmshpërblim nga autopërgjegjësia, Ujdia Jashtëgjyqësore e datës 05.09.2013, Transferi i lëshuar nga paditësja për B.E. në Prishtinë i datës 16.09.2013 së bashku me urdhëresën e transferit dhe Ekspertiza e komunikacionit e datës 02.07.2024.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në nenin 8 të LPK-së, e aprovoi kërkesëpadinë e paditëses dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga ekspertiza e aksidentit të komunikacionit rrugor e datës 02.07.2024, gjykata konstatoj se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me fajin e të paditurit, i cili është kyçur mbrapa në rrugë në mënyrë të pasigurt, dhe nga pakujdesia e ka goditur me rrotën e parë të anës së majtë të veturës këmbësorin këtu të dëmtuarin, në këmbën e djathtë, duke i shkaktuar lëndime trupore të njëjtit. Njëkohësisht, nga kjo ekspertizë gjykata konstatoj se i dëmtuari nuk ka kontribuar në këtë aksident.

Nga marrëveshja jashtëgjyqësore e lidhur në mes të paditëses dhe të dëmtuarit, e datës 05.09.2013, gjykata konstatoj se paditësja është pajtuar më të dëmtuarin për pagesën e shumës prej 746.00 € në emër të kompensimit për dëmin material dhe jo material i shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit i datës 10.07.2013. Ndërsa, nga Transferi i lëshuar nga paditësja për Bankën Ekonomike në Prishtinë i datës 16.09.2013 së bashku me urdhëresën e transferit, gjykata konstatoj se me datë 16.09.2013 e njëjta shumë prej 746.00 € është ekzekutuar.

Nga Raporti i QKUK – Qendra Emergjente i datës 10.07.2013, Vlerësimi mjekësor i datës 10.07.2013, dhe raportet mjekësore të lëshuara nga QKMF, gjykata konstatoj se i dëmtuari nga aksidenti i datës 10.07.2013, ka pësuar lëndime të lehta trupore, si ndrydhje dhe gërvishje të indeve të buta të këmbës së djathtë, për të cilat është trajtuar në institucionet përkatëse shëndetësore.

Rrjedhimisht, përmes këtyre provave vërtetohet se paditësja BKS si pasojë e aksidentit të ndodhur me datë 10.07.2013, me automjetin që e drejtonte i padituri pa mbulesë sigurimi, është detyruar që të dëmtuarit t'i paguaj shumën prej 746.00 €.

Në bazë të provave të prezantuara dhe gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë, gjykata konstaton se në këtë çështje juridike kontestuese duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, dhe dispozitat e Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Me paragrafin 1 të nenit 136 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, përcaktohet se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”* Në rastin konkret, dëmi është shkaktuar nga i padituri, dhe kjo konstatohet nga ekspertiza e komunikacionit e datës 02.07.2024, dhe Raporti i Aksidentit i lëshuar nga Policia e Kosovës me datë 10.07.2013.

Me nenin 18 paragraf 1 të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia parashihet se: *“1. Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësise, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja.”*. Kurse me paragrafin 4 të po të njëjtit nen parashihet se: *“4. Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat.”*. Në rastin konkret, i dëmtuari përmes përfaqësuesit të tij, ka kërkuar dëmshpërblimin nga paditësja, dhe i njëjti është kompensuar për dëmin e shkaktuar nga i padituri, i cili kishte shkaktuar aksidentin duke drejtuar mjetin e pa siguruar. Sipas dispozitës ligjore të lartcekur, paditësja në rastin

konkret, ka të drejtë të kërkojë regres nga i padituri i cili mbahet përgjegjës për shkaktimin e dëmit, në raport me dëmet që i janë kompensuar personit të tretë të dëmtuar.

Gjykata duke u bazuar gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë, erdhi në përfundim dhe konstatoj se ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj paditëses për rimbursimin e mjeteve, në shumën prej 746.00 €, e duke u bazuar në dispozitat e nenit 245 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet të Detyrimeve, i cili shprehimisht parasheh se: *“kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, dhe si rezultat i kësaj paditësjë ka paguar në tërësi dëmin e shkakuar nga i padituri, me ç’rast i padituri ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësen, në të cilin raport paditësjë e ka cilësinë e kreditorit kurse i padituri e ka cilësinë e debitorit.

Përmes administrimit të provave, është arritur të vërtetohet gjendja faktike se i padituri në momentin e aksidentit ka qenë duke lëvizur mbrapa me shpejtësi rreth 10-15 km/h në Rr. “V.F.”, andaj mbi bazën e të gjitha provave të administruara në këtë procedurë, gjendjes faktike të vërtetuar mbi bazën e këtyre provave, përfundimisht gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe duhet të aprovohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Bazën juridike të kërkesëpadiës gjykata e konstatoj përmes ekspertizës së komunikacionit, e cila sipas vlerësimit të gjykatës ishte e hartuar në mënyrë profesionale, e po ashtu në seancën e shqyrtimit kryesor prezent ishte edhe eksperti i komunikacionit i cili u është përgjigjur pyetjeve të palëve ndërgjyqëse dhe gjykatës, duke dhënë sqarime të nevojshme lidhur me ekspertizën e hartuar. Ndërsa, mbi lartësinë e kërkesëpadiës, gjykata vendosi duke u bazuar në marrëveshjen jashtëgjyqësore e lidhur në mes të paditëses dhe të dëmtuarit, e datës 05.09.2013, nga e cila gjykata konstatoj se paditësjë është pajtuar më të dëmtuarin për pagesën e shumës prej 746.00 € në emër të kompensimit për dëmin material dhe jo material i shkakuar nga aksidenti i komunikacionit i datës 10.07.2013. Kurse, nga Transferi i lëshuar nga paditësjë për B.E. në Prishtinë i datës 16.09.2013 së bashku me urdhëresën e transferit, gjykata konstatoj se me datë 16.09.2013 e njëjta shumë prej 746.00 € është ekzekutuar.

Në të njëjtën kohë, gjykata i vlerësoj edhe pretendimet e të paditurit, i cili përmes përgjigjes në padi dhe në seancat gjyqësore ka deklaruar se kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditëses dhe se provat përmes së cilave është vërtetuar gjendja faktike janë të pavërteta dhe të pasakta, gjykata vlerëson se pretendimet e tilla janë të paqëndrueshme. Kjo për faktin se, gjykata nga Raporti i Policisë i datës 10.07.2013, dhe nga ekspertiza e komunikacionit e datës 02.07.2024, konstatoj se i padituri në momentin e aksidentit ka qenë duke lëvizur mbrapa me shpejtësi rreth 10-15 km/h, i cili nga pakujdesia dhe jo vigjilenca e duhur ka shkakuar aksidentin, dhe ky raport dhe ekspertiza e komunikacionit, për gjykatën ishin prova të mjaftueshme për të konstatuar bazën e kërkesëpadiës, përderisa i padituri nuk ka ofruar asnjë provë para gjykatës për të argumentuar të kundërtën. Për me shumë, i padituri nuk ka ofruar prova para gjykatës, e po ashtu nuk ka paraqitur propozime për të vërtetuar një gjendje ndryshe nga ajo e konstatuar sikurse më lartë, dhe lidhur me këtë me paragrafin 2 të nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, kurse në lidhshmëri me këtë, me

nenin 322 paragraf 2 të LPK-së, është paraparë se: *“pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provoj faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.”*

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u bazuar në dispozitat e nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, e cila përcakton se debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor edhe kamatën, ndërsa lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit. Si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurit për pagesën e kamatës, gjykata ka caktuar datën 08.10.2024, datë kjo kur është nxjerr aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bart shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, e lidhur me nenin 463 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve në emër të pagesës së taksës gjyqësore shumë prej 20.00 € dhe në emër të ekspertizës së komunikacionit shumë prej 150.00 €, gjithsejtë në shumë e përgjithshme prej 170.00 €.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata sipas nenit 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
C.nr. 873/17, datë 08.10.2024

Gjyqtari
Argzon Muçaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të së njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.